



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 22 , Datë 11 / 01 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.137, datë 24.10.2017, të znj.N. H, me objekt pretendimin për diskriminim “për çdo shkak të moshës”, kundër Albtelekom sh.a.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

KONSTATOI:

Referuar ankesës së sjellë pranë Zyrës së KMD-së, subjekti ankues, znj.N. H shprehet se: “ Me datën 08.09.1989 kam filluar punë pranë Telekomit Shqiptar, dega Kukës, në detyrën “Inxhinierë” dhe kam punuar pa ndërprerje deri në datën 07.05.2015. Me shkresën me nr.3800 prot., datë 07.05.2015, jam njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me pretendimin e shkurtimit kolektiv. Në fakt, shkak i vetëm që ky subjekt ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me mua është mosha ime, shkak ky diskriminues”. Pretendimin për ekzistencën e shkakut diskriminues (moshës), si të vetmin motiv për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ana e Albtelecom sh.a. ankuesja e argumenton me parashtrimet poshtëcituar:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- Me datë 30.04.2015, Albtelecom sh.a ka publikuar strukturën e re, në të cilën drejtoria ku punonte znj.H rezultoi të jetë shkurtuar me 4(katër) punonjës, nga 9(nëntë) që ishin në strukturën e mëparëshme. Pra, mbetën në punë 5(pesë) punonjës. Nga të dhënat e datëlindjeve të secilit punonjës, znj.H është e mendimit se janë larguar punonjësit që rezultojnë më të vjetër në moshë dhe janë mbajtur në punë punonjësit me moshë më të re².
- Ankuesja pretendon se ka patur gradën e parë të titullit “Supervisor”, ndërsa të gjithë punonjësit e tjerë kanë qenë me gradë të dytë ose të tretë. Duke qenë se ajo kishte nivelin më të lartë krahasuar me punonjësit e tjerë, ngre pretendimin se përse duhej të largohej ajo nga puna, nëse nuk do të ishte për shkak të moshës së saj?! Ankuesja shprehet se kishte arsimin e lartë në Degën “Elektronikë”.
- Znj. H shprehet se gjatë periudhës 26 vjeçare të marrëdhënieve të saj të punës me këtë subjekt, ka kryer detyra të ndryshme dhe gjithmonë vlerësimi i punës së saj ka qenë “shumë mirë” dhe asnjëherë nuk ka marrë asnjë vërejtje. Lidhur me këtë ajo citon: *“...megjithëse kisha eksperiencën më të gjatë dhe trajnime të shumta, me vlerësime “shumë mirë”zgjodhën të më largonin nga puna. Prandaj jam e mendimit se moshë ka qenë shkak real dhe i vetëm i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga ana e Albtelecom sh.a. Kjo për faktin se në strukturën e re që ka publikuar me datë 30.04.2015, pikërisht në Drejtorinë ku unë kisha punuar “Fix Network Division”, bashkë me publikimin e strukturës dhe të emrave të punonjësve që mbeteshin në punë, ka shpallur dhe 6 vende vakante: 2 vende në N/Drejtorinë “Datacom Team”, 1 vend në N/Drejtorinë “Next Generation Networks Team” dhe 3 vende në N/Drejtorinë IPTV Team”.*
- Me datë 07.05.2015 ankuesja citon se ka aplikuar për vendet vakante të shpallura, por me datë 08.05.2015 është njoftuar nga drejtorja e Burimeve Njerëzore se aplikimi i saj nuk ishte marrë në konsideratë. Znj.H ka nisur gjithashtu një e-mail me anë të të cilit parashtron rishtaz kërkesën e saj për të aplikuar për vendet e shpallura vakante, por përgjigjja ka qenë negative në të dyja rastet.

² Znj.H ka pasqyruar në mënyrë të detajuar të dhënat (referuar datëlindjeve respektive) për secilin punonjës të larguar nga puna dhe të mbajtur në punë.

- Ankuesja shprehet se në bisedat informale me drejtuesit e njësisë ka rezultuar se “i jepet përparësi moshës së punonjësve”, që do të thotë se janë penalizuar punonjësit më të vjetër në moshë përmes largimit nga puna.
- Janë përzgjedhur për t’u larguar nga puna punonjës të kualifikuar me gradën “Supervisor” dhe janë mbajtur në punë punonjës me kualifikim më të ulët, me gradën “Specialist”, që kanë qenë në moshë më të re.
- I njëjti arsyetim vlen edhe për punonjësit që janë rimarrë rishtaz në punë.
- Znj.H shprehet se: *“Largimi nga puna i punonjësve më të vjetër dhe me në shumë kualifikime ka të bëjë edhe me interesin ekonomik të subjektit në fjalë, për shkak se largimi i një punonjësi me kualifikime të larta dhe kohëzgjatje të marrëdhënieve të punës, i jep mundësi subjektit të marrë dhe të mbajë me të njëjtin nivel shpenzim page, disa punonjës që merren rishtaz; të rinj, pa kualifikime dhe pa eksperiencë pune”*.
- Subjekti ankues mendon se për të gjitha arsyet sipërcituar, Albtelecom sh.a e ka diskriminuar duke ndërprerë marrëdhëniet e punës me të, pikërisht për shkak të moshës së saj.

Në përfundim, znj.H shprehet se: *“...kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj saj nga ana e subjektit Albtelecom sh.a, për shkak të moshës, si dhe të vendosë sanksione ndaj këtij subjekti”*.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, **moshën**, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*

Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti ankues në formularin e ankesës, si dhe në dokumentacionin e depozituar pranë Zyrës së KMD-së nga vetë ajo, Komisioneri, konstaton se

znj.H i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin Albtelecom sh.a, me datë 07.05.2015, datë në të cilën dhe ka marrë dijani. Ky fakt është i pranuar nga vetë subjekti ankues:

- referuar deklarimeve të saj në formularin e ankesës sjellë pranë KMD-së. (faqja nr.10 e ankesës, ku citohet se **koha kur ka ndodhur diskriminimi dhe koha e marrjes dijani të diskriminimit të pretenduar është me datë 07.05.2015**).
- Referuar shkresës me nr.3800 prot., datë 07.05.2015 “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albtelecom sh.a”, depozituar në dosje nga vetë ankuesja.

Pra, *subjekti ankues ka marrë dijani për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që më datë 07.05.2015,³ ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 24.10.2017⁴, pra më vonë se një vit nga marrja dijani.*

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e znj.H, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...*”.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ...”*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁵ të*

³ Gjë që e ka deklaruar edhe në formularin e ankesës të plotësuar pranë KMD-së, si dhe në shkresat shoqëruese.

⁴ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje”.

Duke qenë se ankuesi është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁶, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e saj për diskriminim, Komisioneri i rekomandon subjektit ankues që t'i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, neni 33, pika 10, dhe nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU
KOMISIONERI

Fusha: Punësim
Shkaku: Mosha

⁵ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmëpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

⁶ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.